VENDIM
Nr.380, datë 18.5.2011

PËR NGRITJEN, ORGANIZIMIN DHE MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT SHKENCOR TË INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 13 të ligjit nr.10 138, datë 11.5.2009 "Për shëndetin publik", me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Këshillit Shkencor (KSH) të Institutit të Shëndetit Publik (ISHP), si organ këshillimor i këtij instituti.

2. KSH-ja drejton punën në ISHP, duke përcaktuar përparësitë dhe duke vlerësuar cilësinë dhe frytshmërinë e punës së kryer. Ky Këshill, gjithashtu, vlerëson vlefshmërinë shkencore e etikën e programeve të kërkimit apo të ndërhyrjes dhe programet e edukimit në vazhdim në fushën e shëndetit publik, si dhe drejton plane të zhvillimit strategjik, strukturor, teknologjik dhe të burimeve njerëzore në ISHP.

3. Këshilli Shkencor i ISHP-së kryesohet nga drejtori i këtij instituti dhe ka në përbërje këta anëtarë:

a) një përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë;

b) tre përfaqësues nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë, njëri nga të cilët është përfaqësues i Departamentit të Shëndetit Publik;

c) një përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;

ç) një përfaqësues nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;

d) një përfaqësues nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;

dh) një përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës;

e) gjashtë anëtarë të tjerë emërohen nga drejtori i ISHP-së, ndërmjet specialistëve të këtij instituti, me gradë dhe/ose titull shkencor.

4. Ministri i Shëndetësisë, kur e sheh të arsyeshme, merr pjesë në mbledhjet e Këshillit Shkencor të ISHP-së.

5. KSH-ja mblidhet në mënyrë të rregullt, të paktën dy herë në vit, për të analizuar e për të vlerësuar punën e kryer nga ISHP-ja dhe për të drejtuar përparësitë dhe veprimtaritë e ardhshme. KSH-ja mund të mblidhet, për raste të veçanta, dhe nga drejtori i ISHP-së ose nga jo më pak se 1/3 e anëtarëve të tij. Mbledhja hapet dhe zhvillohet kur marrin pjesë jo më pak se 2/3 e anëtarëve.

6. Në mbledhjet e Këshillit Shkencor merr pjesë dhe sekretari i Këshillit, i cili caktohet nga drejtuesi i këtij Këshilli.

7. Sekretari i Këshillit Shkencor ka këto detyra:

a) merr masat organizative për përgatitjen e mbledhjeve të Këshillit Shkencor të ISHP-së;

b) informon me shkrim anëtarët e Këshillit Shkencor të ISHP-së për ditën, orën, rendin e ditës dhe i pajis anëtarët me materialet e informacionin e duhur;

c) mban procesverbalin e mbledhjes;

ç) dërgon procesverbalin e mbledhjes së Këshillit Shkencor të ISHP-së te të gjithë anëtarët;

d) mban dokumentacionin e Këshillit Shkencor të ISHP-së.

8. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Shëndetit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha